

VENDIM
Nr.720, datë 22.6.2009

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQEVE, QË DO TË
TJETËRISOHEN, NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “MANE TCI” SHPK, PËR
LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr.12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme me nr.737 (vol.5, f.81, zona kadastrale 2529), me sipërfaqe 7 000 (shtatë mijë) m², dhe nr.863 (vol.4, f.62, zona kadastrale 2529), me sipërfaqe 2 400 (dy mijë e katërqind) m², të regjistruara në ZRVPP, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “MANE TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqeve, që tjetërsohen, të përllogaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, të Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës.

3. Vlera e sipërfaqeve, që tjetërsohen, të paguhet nga subjekti kërkues “MANE TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë zyrës qendrore të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha